



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit :21.3.1-2010-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SË
TREGTISË DHE INDUSTRIË PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31
DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje	5
II. Opinioni i auditimit.....	6
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	7
IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.....	8
V. Pasqyrat financiare.....	9
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	9
V.2 Cilësia e informatave	9
VI. Realizimi i Buxhetit	10
VI.1 Të hyrat	10
VI.2 Shpenzimet.....	12
VI.3 Subvencionet dhe transferet	14
VII. Kontrolli menaxherial	17
VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	17
VII.2 Auditimi i Brendshëm.....	17
VIII.Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MTI-së	18
Shtojca I. Komentet e MTI-së dhe përgjigjet e ZAP-it.....	19
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opioneve të Auditimit.....	26

Lista e shkurtesave

APIK	Agjensioni për Promovimin e Investimeve në Kosovë
KPM	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës
LMFPP	Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligjin nr. 2003/17 për Prokurimin Publik në Kosovë me ndryshimet dhe Plotësimet e datës 8 shkurt 2007
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MEF	Ministria për Ekonomi dhe Financa
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SNISA	Standardet Nderkombetare të Institucioneve Supreme të Auditimit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzimi Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA), të hartuara nga ONISA (INTOSAI) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuam mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe të hyrave nuk është i plotë.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe të hyrave sipas departamenteve adekuate nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*)

Auditimi ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet performanca e organizatës.

Mangësi kishte gjatë mbledhjes dhe raportimit të të hyrave.

Procedurat e prokurimit nuk ishin zhvilluar në pajtim të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore. Gjate rekrutimit të stafit nuk ishin respektuar kriteret e përcaktuara. Menaxhimi i subvencioneve lë hapësirë për përmirësim.

Pasuritë nuk ishin menaxhuar mjaftueshëm. Kjo krijon hapësirë për humbje dhe keqpërdorimin e tyre.

Duke u bazuar në këto dobësi konkluzioni ynë i përgjithshëm është se nevojiten masa shtesë nga menaxhmenti i MTI-së për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Andaj ne rekomandojmë Ministrin që të siguroj:

- Përgatitjen e pasqyrave financiare plotësisht në pajtim me standardet dhe kërkesat ligjore;
- Planifikim dhe përdorim efektiv dhe efikas të buxhetit;
- Regjistrim të të hyrave në kodet adekuate. Po ashtu dhënia e licencave për subjektet ndërtimore të jetë në pajtim me UA 10/2010;
- Që blerjet përmes prokurimit të jenë në pajtim me kërkesat ligjore të LPP-së;

- Respektimin e kriterëve të vendosura gjatë përzgjedhjes së kandidatëve;
- Që pagesave për subvencione paraprisht tu paraprijnë kontratat e përgjithshme; dhe
- Mbajtjen e regjistrit të plotë dhe të saktë për pasuri, në aspektin financiar dhe sasior.

Dobësitë e vërejtura tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon të përmirësohet. Andaj ne rekomandojmë Ministrin të siguroj se kontrollet e përgjithshme të brendshme janë forcuar në mënyrë që të ofrojnë siguri që aktivitetet operative dhe menaxhimi financiar funksionojnë në pajtim me objektivat e vendosura të MTI-së.

Menaxhmentit të MTI-së i është dhënë mundësia për të bërë komente në draftin e këtij raporti. Në këtë raport janë bërë më pas një numër ndryshimesh.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën 1.

Menaxhmenti është zotuar që do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të MTI-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e MTI-së të përgatisë PVF sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) 16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë, në rastin tonë ne jemi fokusuar në institucionin tuaj.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Gjatë vitit aktual (2010) ne kemi kryer një auditim të përkohshëm në institucionin tuaj, duke trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe adresimin e çështjeve të menaxhimit financiar

gjatë vitit aktual. Kemi këshilluar menaxhmetin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e MTI-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF të MTI-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse PVF të MTI-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në MTI

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF për vitin 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të MTI-së, SNA përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara me gjerësisht në Shtojcën 2.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe të hyrave nuk është i plotë.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe të hyrave sipas departamenteve adekuate nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*)

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin tonë të auditimit të PVF të vitit 2009 janë dhënë nëntë rekomandime kryesore.

Rekomandimet të cilat kanë arritur të adresohen janë:

- Sigurimi i tri ofertave të përgjegjshme dhe zhvillimi i procedurave të vlerësimit para nënshkrimit të kontratave; dhe
- Respektimi i kriterëve të kërkuara në dosjen e tenderit gjatë vlerësimit të ofertave dhe siguria e ekzekutimit të jetë në pajtim me kërkesat në dosjen e tenderit;

Rekomandimet të cilat janë adresuar pjesërisht janë:

- Është adresuar pjesa e harmonizimeve në mes të departamentit të financave dhe departamenteve që realizojnë të hyra, ndërsa verifikimi i licencave të dhëna nuk ishte adresuar;
- Rekomandimi katër për vendosjen e kriterëve të qarta dhe të përcaktohen në konkurs publik është adresuar, ndërsa mundësia e barabartë nuk iu ishte dhënë të gjithë kandidatëve për shkak të vlerësimit jot ë drejt;
- Rekomandimi shtatë është adresuar pjesa për mbajtjen e evidencave mbi pranimin dhe daljen e pasurive nga depoja, ndërsa ende nuk ishte regjistruar e gjithë pasuria në regjistrin kontabël; dhe
- Rekomandimi nëntë NJAB kishte përgatitur raporte për të hyrat mirëpo nuk kishte audituar prokurimin që është një prej fushave që paraqesin rrezik të lartë:

Rekomandimet te cilat janë në proces të adresimit ishin:

- Marrja e masave të menjëhershme që të gjitha pasuritë të regjistruhen në Free Balance në pajtim me kërkesat e UA 21/2009;
- Vendosja e kontrolleve të përshtatshme mbi proceset e procedurave të prokurimit për të gjitha fazat e zhvillimit të procedurave deri në finalizimin e kontratave; dhe
- Të gjitha automjetet e MTI-së do të shfrytëzohen në pajtim me UA 03/2008 për përdorimin e automjeteve të qeverisë së Kosovës.

MTI kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i auditimit për vitin 2009, mirëpo nuk është marrë seriozisht me adresimin e rekomandimeve tona sipas PVF për adresimin e tyre.

Një situatë e tillë ngrit shqetësimin tonë, sepse mos adresimi i plotë i rekomandimeve nga vitet e kaluara, ka bërë që problemet e njëjta të janë evidente edhe në vitin aktual.

IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar 2010	Buxheti i shpenzuar 2009
Grandi i Qeverisë – Buxheti	8,773,091	9,771,460	9,660,158	8,069,734	6740,368
Donacionet e jashtme	1,037,093	1,011,304	1,011,304	922,679	258,894
I. Gjithsej të hyrat	9,810,184	10,782,764	10,671,462	8,992,413	6,999,217
Paga dhe mëditje	752,457	801,129	801,129	748,812	601,860
Mallra dhe shërbime	1,782,406	2,799,912	2,799,912	2,421,853	1,396,255
Shpenzimet komunale	85,680	55,680	35,680	30,566	33,727
Subvencione dhe transfere		400,000	400,000	324,267	
Investime Kapitale	7,189,641	6,726,049	6,634,741	5,466,915	4,967,375
Rezervat					
II. Gjithsej shpenzimet	9,810,184	10,782,764	10,671,462	8,992,413	6,999,217

Buxheti final për vitin 2010 ishte në shumë 10,671,462€ që tregon një ulje në krahasim me buxhetin e rishikuar në shumë prej 111,302€ Zvogëlimi i buxhetit final në krahasim me buxhetin e rishikuar ishte për shumat e deklaruara si kursime buxhetore siç janë;

Buxheti i final për komunalin ishte zvogëluar në shumën prej 20,000€ Kategoria për investime kapitale ishte zvogëluar, sipas vendimit të qeverisë së Kosovës nr. 01/149 të datës 07.12.2010 në shumën prej 91,308€ për reduktime buxhetore nga kategoria e investimeve kapitale.

Buxheti i shpenzuar gjatë vitin 2010 ishte 8,992,413€ ose në masën 84% të buxhetit final. Arsyeja kryesore që kishte ndikuar në mos shpenzimin e buxhetit final në masën prej 16% ishte mos realizimi disa projekteve kapitale që ishin planifikuar.

Implementimi i dobët i buxhetit gjatë nëntëmuajorit të parë, ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve në tremujorin e fundit vitit. Vetëm në tremujorin e fundit janë shpenzuar 55% e buxhetit nga kategoria mallra dhe shërbime dhe 41% në kategorinë e investimeve kapitale.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se ekzekutimi i buxhetit ishte i një niveli jo të kënaqshëm, sidomos për kategoritë mallra e shërbime dhe investime kapitale. Kjo ka rrjedhur kryesisht nga vonesat në implementimin e projekteve të parashikuara.

Vonesat në kryerjen e projekteve të parashikuara ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve në fund të vitit .

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së të siguroj:

- Planifikim dhe përdorim efikas dhe racional të buxhetit duke u bazuar në identifikimin e drejtë të nevojave buxhetore.

V. Pasqyrat financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Pasqyrat financiare, me përjashtim të prezantimit të pasurisë dhe shpalosjes së të hyrave sipas departamenteve adekuate, janë në harmoni me kërkesat e UA 16/2010 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave buxhetore dhe SNKSP “Raportimin Financiar në bazë të parasë së Gatshme”
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar me datën 17.03.2011;
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në MEF/Thesar, me datën 31.01.2011. Mirëpo pas sugjerimit tonë për korrigjim, versioni i fundit është dorëzuar me datën 18.03.2011
- Gjatë vitit 2010, MTI ka përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta financiare tremujore tek Ministri i MEF-it.

V.2 Cilësia e informatave

Përgatitja e pasqyrave financiare duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, proceduar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare të MTI-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010, fillimisht të dorëzuara në MEF, përmbanin gabime sa i përket saktësisë së të dhënave të prezantuara.

Gjatë procesit të auditimit ne kemi këshilluar menaxhmentin e MTI-së që të korrigjoj gabimet e identifikuara në versionin e parë.

Pas sugjerimit tonë, Pasqyrat Financiare të MTI-së janë korrigjuar dhe dërguar për here të dytë në Thesar.

Përkundër korrigjimeve të bëra, vlera e pasurive e prezantuar në PVF nuk ishte e plotë dhe e saktë. Regjistrimi i të hyrave nuk ishte bërë sipas departamenteve adekuate në SIMFK, që ka ndikuar në prezantimin jo të saktë të të hyrave sipas departamenteve.

Konkluzioni

Regjistri i pasurive nuk ishte i plotë dhe përmbante gabime. .

Mos regjistrimi i të hyrave sipas departamenteve adekuate në SIMFK ka ndikuar në prezantimin jo të drejtë dhe të saktë të gjendjes së tyre.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së që të siguroj:

- Korrigjimin e gabimeve në regjistrat kontabël dhe regjistrimin e plotë të pasurive të jenë në pajtim me kërkesat e raportimit financiar, si dhe paraqitjen e tyre të saktë në PVF; dhe
- Prezantimin dhe shpalosjen e të hyrave në PVF sipas programeve adekuate të përcaktuara në planin kontabël.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të hyrat

Gjatë vitit 2010 të hyrat e mbledhura ishin në shumë prej 2,671,392€ Te hyrat më të larta që kishte inkasuar MTI gjatë vitit 2010 ishin nga taksat për importin e produkteve të naftës, regjistrimi i bizneseve, licencimi i subjekteve nga sektori i naftës dhe derivateve të naftës, licencimi i subjekteve ndërtimore, pronësia industriale dhe meteorologjia.

Gjatë auditimit të hyrave në MTI kemi testuar procesin e regjistrimit të hyrave sipas programeve. Testimet tona kanë shpalosur të gjeturat në vijim:

Regjistrimi i të hyrave nuk ishte bërë sipas programeve përkatëse

Të hyrat e realizuara sipas departamenteve duhet të regjistrohen në kodet përkatëse në pajtim me klasifikimin e përcaktuar në planin kontabël. Ndërsa ne kemi vërejtur se të hyrat e inkasuara nuk janë regjistruar sipas tyre, si për shembull;

- Të hyrat nga licencat ndërtimore për vitin 2010 në shumë prej 250,351€ ishin mbledhur nga departamenti i ndërtimtarisë, ndërsa ishin regjistruar në kodin 41100 (departamenti i tregtisë);

- Të hyrat për pronësi industriale në shumë prej 298,056€ishin mbledhur nga Zyra për pronësi industriale, ishin regjistruar në kodin 11304 (departamenti i administratës qendrore); dhe
- Të hyrat nga zyra për licencimin e sektorit të naftës ishin mbledhur nga departamenti i licencimit në shumë prej 506,963€ ishin regjistruar në kodin 41000 (departamenti i tregtisë).

Licencat e dhëna subjekteve ndërtimore nuk ishin në pajtim me UA nr. 10/2010

Sipas nenit 17 të UA 10/2010 të MTI-së, në sektorin e ndërtimitarisë, për tu pajisur me licencë paraprakisht duhet të dorëzohen dëshmitë në lidhje me: përvojën përkatëse për punë të stafit teknik, pajisjet dhe referencat për punë.

Gjatë viti 2010, MTI kishte lëshuar licenca ndërtimi subjekteve ndërtimore që nuk kishin plotësuar kriteret e përcaktuara. Gjatë testimeve tona, ne kemi vërejtur se në dy raste mungonin dëshmitë për pajisjet dhe përvojën e punës së stafit, ndërsa në një rast mungonin referencat për punët e kryera nga aplikuesit për licenca.

Te hyrat nga procesi i shitjes së automjeteve përmes ankandit publik nuk ishin në pajtim me UA 2008/3 (procedurat e shitjes së mallrave me ankand publik)

Në pajtim me nenin 17.4 të Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme, MTI ka nxjerrë rregullore të cilat përcaktojnë kushtet për organizimin e ankandit, regjistrimin e mallit që shitet në ankande, mënyrën e afarizmit dhe procedurën e shitjes .

Sipas nenit 5 të UA 2008/3 të MTI-së për procedurat e shitjes së mallrave me ankand publik komisioni përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë të komisionit. Komisioni është "ad hoc" dhe emërohet pak orë para se të mbahet ankandit publik.

Komisioni për shitjen e 308 automjeteve në ankand publik në shumë 121,000€plus TVSh-ja, i datës 28.05.2010 ishte në përbërje të pesë anëtarëve dhe ishte formuar gjashtëmbëdhjetë muaj para mbajtjes së ankandit publik (më datë 22.01.2009).

Shpallja e fituesit bëhet nga komisioni që duhet të njoftoj me shkrim fituesin për formën dhe kohën e pagesës. Pagesa duhet të bëhet në afat prej pesë ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit.

Afati i caktuar nga komisioni për kryerjen e obligimeve (pagesës) në afat prej shtatë ditësh ishte në kundërshtim me UA 2008/03

Konkluzioni

Ne vlerësojmë se MTI nuk kishte kontrolle funksionale gjatë menaxhimit dhe raportimit të të hyrave. Si pasojë nuk kishte raportim të drejtë, si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme gjatë realizimit të hyrave.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së të siguroj:

- Regjistrimin e të hyrave në programet sipas kodeve adekuate, në mënyrë që të prezantojë drejtë dhe saktë të hyrat e inkasuara;
- Që licencat e dhëna subjekteve për ushtrimin e punëve në sektorin e ndërtimtarisë të janë në pajtim të plotë me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me UA 10/2010; dhe
- Që shitja e mallrave përmes ankandeve publike, të jetë në pajtim të plotë me UA 2008/3 për procedurat e shitjes së mallrave me ankand publik.

VI.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

Sipas planit të prokurimit për vitin 2010 vlera e parashikuar e kontratave ishte në shumë 2,806,124€ ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara ishte në shumë 2,569,265€ ose në masën 91% nga shuma e planifikuar. Ne kemi testuar dymbëdhjetë mostra ose shumën 806,265€ që ishin në masën 31% nga shuma e kontratave të nënshkruara.

Ne vazhdim kemi paraqitur të gjeturat e identifikuara gjatë auditimit nga mostrat e testuara për kategorinë e mallrave e shërbimeve dhe investimeve kapitale si në vijim:

Pagesa në shume prej 1,448,000€ para fillimit të punimeve

Afati për përmbushje të kontratës së nënshkruar më datën 19.11.2009 për “Ndërtimin e Rrjetit për Furnizim Emergjent me Energji në Parkun e Biznesit në Drenas” ishte 250 ditë nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Sipas raportit të organit mbikëqyrës të datës 23.09.2010 punimet ende nuk kishin filluar për pjesën ku do të vendoset TS 35/10kV që përbënte vlerën kryesore të kontratës. Arsyeja për këtë ishte problemi i pronave se ku do të vendosën shtyllat elektrike. Kjo nuk ishte zgjidhur nga komuna e Drenasit.

Pagesat për këtë kontratë në shumë prej 1,448,000€ ishin bërë para fillimit të punimeve.

Vonesa në realizimin e projektit për shkak të problemeve pronësore

Sipas kontratës për “Ndërtimin e kanalizimit të impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe industriale të Parkut të Biznesit dhe Zonës Industriale” në Drenas, periudha e kryerjes së punëve duhet të përfundojë në bazë të planit dinamik brenda 21 ditë pune nga data e fillimit.

Kjo kontratë ishte nënshkruar më datën 13.07.2010 në vlerë prej 284,814€ ndërsa deri më datën 15.03.2011 (gjatë kohës sa ishim në auditim) vlera e punimeve të kryera ishte në shumën prej 229,475€ ose në masën 80% e vlerës së kontratës. Vonesat në realizimin e projektit janë shkaktuar nga mos zgjidhja e problemeve pronësore.

Pagesat nuk ishin në pajtim kushtet e kontratës

Sipas kontratës së nënshkruar më datën 25.06.2010 në shumë prej 9,964€ për servisimin dhe mirëmbajtje të automjeteve të MTI-së –Loti II, garancioni për pjesë të ndërruara, do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se ishin ndërruar dhe paguar nga dy herë pjesët e njëjta të automjeteve brenda periudhës dy mujore, për automjetet: Toyota 526-KS-249 në shumë prej 1,440€ dhe Toyota 518-KS-861 shuma prej 440€

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se sistemi i prokurimit nuk kishte funksionuar si duhet. Menaxhimi i procedurave të prokurimit nuk ishte në pajtueshmëri të plotë me LPP-në, për çka edhe kanë rrjedhur parregullsi gjatë ekzekutimit të kontratave.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së që të siguroj:

- Përmirësimin procesit të prokurimit dhe kontrollit. Në rastet kur pagesat janë kryer para fillimit të punimeve, Sekretari i Përgjithshëm të bëjë analizimin e mëtutjeshëm dhe marrjen e masave të aplikueshme administrative; dhe
- Identifikimin dhe zgjedhjen e problemeve pronësore para fillimit të realizimit të projekteve, në mënyrë që të evitohen kontestet që mund të shkaktojnë pengesa gjatë implementimit të projekteve.

2.2 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2010 ishte në shumën 771,129€ Prej tyre ishin shpenzuar 748,812€ ose në masën 97%. Gjatë auditimit të kësaj kategorie, testuam dosjet të personelit, ku në të njëjtat kemi gjetur se ka pasur mangësi rreth menaxhimit dhe rekrutimit të stafit si vijon:

Përzgjedhja e kandidatëve nuk ishte bërë në mënyrë të drejtë

Përzgjedhja e kandidateve duhet të bëhet në bazë të kriterëve të kërkuara në konkurs për pozitat përkatëse. Ne dy raste ishin përzgjedhur e kandidatet që nuk i plotësonin kushtet e kërkuara në konkurs.

MTI nuk i ka përfillur vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM)

Vendimet e këshillit paraqesin vendimet administrative të formës së prerë dhe ekzekutohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

MTI në dy raste nuk kishte zbatuar vendimet e KPM-së për pozitën drejtor i departamentit ligjor dhe udhëheqës i divizionit për zhvillim industrial dhe rregulla teknike.

Kandidatet e përzgjedhur vazhdojnë të kryejnë detyrat duke mos respektuar vendimet e KPM-së.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se MTI gjatë rekrutimit të stafit nuk kishte përzgjedhur kandidatet të cilët i plotësonin kriteret e kërkuara në konkurs. Si pasojë e mos vlerësimit të drejtë të kandidateve, KPM kishte aprovuar ankesat e kandidateve të diskriminuar dhe kishte anuluar vendimet e komisioneve të vlerësimit.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së që të siguroj:

- Përzgjedhjen e kandidateve në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil; dhe
- Zbatimin e vendimeve të nxjerra nga KPM.

VI.3 Subvencionet dhe transferet

Subvencionet sipas buxhetit final të MTI-së për vitin 2010 ishin në shumë 400,000€ Prej tyre ishin shpenzuar 324,267€ ose në masën 81%. Ne kemi testuar dy mostra në shumën 47,000€ që ishin në masën 14% e shumes totale e shpenzimeve për subvencione .MTI kishte subvencionuar agjensionet e pavarura për programe të ndryshme lidhur me promovimin e bizneseve vendore brenda dhe jashtë vendit.

Nënshkrimi i kontratës së veçantë para nënshkrimit të kontratës së përgjithshme

Kontrata e përgjithshme duhet të i'u paraprij kontratave të veçanta, për dhënien e subvencioneve në bazë të projekteve dhe programeve përfituese. Ne kemi vërejtur se nënshkrimi i kontratës së përgjithshme për subvencionin e projektit “Misioni i edukimit dhe nxitje së tregtisë mes Kosovës dhe SHBA” në shumë 25,000€ është bërë pas nënshkrimit të kontratës së veçantë.

Shpenzimet ish-in bërë para nënshkrimit të kontratës

Sipas nenit 43.4 të rregullës së Thesarit 02 për shpenzimin e parave publike, pagesat e subvencioneve duhet të bazohen në një marrëveshje zyrtare mbi formën e subvencionimit.

Shpenzimet për projektin “Javët e Biznesit Kosovar 2010” kishin ndodhur para nënshkrimit të kontratës së veçantë. Gjithashtu edhe profatura në shumë 22,000€ ishte përgatitur para datës së nënshkrimit të kontratës.

Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës

Zotimi i mjeteve për subvencione, sipas nenit 28 të rregullës së thesarit 02/2009, duhet të bëhet para nënshkrimit të kontratës. Zotimi i mjeteve për projektin “Misioni i edukimit dhe nxitje së tregtisë mes Kosovës dhe SHBA” në shumë 25,000€ është bërë një muaj pas nënshkrimit të kontratës së veçantë.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se menaxhmenti i MTI nuk kishte vendosur kontrole të mjaftueshme për ndjekjen e procedurave në lidhje me shpenzimin e parave nga subvencionet. Si pasojë e mungesës së kontrollit të mjaftueshëm, kontratat e përgjithshme ish-in nënshkruar pas nënshkrimit të kontratave të veçanta. Shpenzimi ka ndodhur para nënshkrimit të kontratave.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së që të siguroj:

- Vendosjen e kontroleve të mjaftueshme për shpenzimin e parave nga subvencionet në mënyrë që kontratat e përgjithshme për projektet fituese tu paraprijnë kontratave të veçanta;
- Që të mos bëhen shpenzime para nënshkrimit të kontratave për projekte të caktuara; dhe
- Zotimin e mjeteve para nënshkrimit të kontratave.

3.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Vlera origjinale e pasurive sipas regjistrimit kontabël të pasurive ishte në shumë 15,879,873€ ndërsa pas zhvlerësimit vlera neto e pasurive ishte 14,320,414€

Gjate auditimit ne kemi testuar se a janë regjistruar pasuritë drejtë dhe saktë në regjistrin kontabël sipas sasisë dhe vlerës dhe a janë prezantuar drejtë në pasqyra financiare gjate vitit 2010.

Regjistrat e pasurive nuk paraqesin gjendjen e drejtë dhe të saktë

Sipas UA 21/2009 Zyrtari i pasurive duhet të regjistrojë të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël në bazë të faturës dhe fletëpranimit të pasurive.

Ne kemi vërejtur se kishte përmirësime sa i përket regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin 2009. Edhe përkundër përmirësimeve zyrtari i pasurive akoma nuk kishte arritur të përpilojë regjistra të plotë dhe të saktë për të gjithë pasuritë që ishin në kuadër të MTI-së.

Dobësitë e identifikuara janë si vijim:

- në regjistrat kontabël të pasurive, pesë vetura në shumë prej 153,657€ ishin regjistruara gabim;
- tri vetura të shitura në shumë 10,833€ ishin prezantuar si pasuri e MTI-së; si dhe
- pasuritë jashtë përdorimit në shumë prej 43,000€ nuk ishin larguar prej regjistrave të pasurive.

Menaxhimi i automjeteve

Përdorimi i automjeteve duhet të bëhet duke ndjekur procedurat e përcaktuara në UA 03/2008 për përdorimin e rregullt dhe efikas të automjeteve siç janë: plotësimin e kërkesës për shërbime të vozitjes, çdo drejtues është i obliguar që në fletudhëtim të shënoj numrin e kilometrave në momentin e nisjes dhe të kthimit dhe raporti për shpenzimet e karburanteve. Auditimi ynë shpalosi të gjeturat në vijim:

- shpenzime të karburanteve mbi normativin e paraparë gjatë shfrytëzimit të automjeteve në vitin 2010; dhe
- në disa raste mungonin autorizimet për lejimin e shfrytëzimit të automjetit, plotësimi i fletudhëtimeve nuk ishte në mënyrën e duhur për kilometrat e kaluar.

Konkluzioni

Mungesa e regjistrimit të gjithë pasurisë që disponon ministria dhe regjistrimet gabim në regjistrat kontabël krijojnë hapësirë për humbje dhe keqpërdorimin e tyre. Po ashtu harxhimi i karburanteve mbi normën e paraparë për automjete krijon mundësi për keqpërdorime gjatë shfrytëzimit të automjeteve.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së që të siguroj:

- Mbajtjen e të dhënave të sakta për pasuritë sipas sasive dhe vlerës;
- Shfrytëzimin e veturave në pajtim të plotë me UA 03/2008 dhe evidenca të sakta rreth shërbimeve dhe mirëmbajtjes se tyre; dhe
- Që shpenzimet e karburanteve për automjete të jenë brenda normës së paraparë. Në raste kur vërehen shpenzime mbi normën e lejuar të analizohen dhe të gjinden shkaqet dhe të merren masat e nevojshme për evitimin e tyre.

VII.Kontrolli menaxherial

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Ne kemi identifikuar dobësi në menaxhimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e paraqitura në seksionet më lartë. Kjo përfshinë edhe dështimin në adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të pasqyrave financiare që është tregues i qartë se dobësitë nga viti i kaluar janë akoma evidente.

Konkluzioni

MTI nuk kishte arritur të vendos kontrolle funksionale të cilat do të siguronin menaxhim efektiv të parasë publike. Këto kontrolle nuk kanë arritur të parandalojnë gabimet dhe parregullsitë e paraqitura.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së të siguroj:

- Adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëhershme; dhe
- Forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm përmes mbikëqyrjes së gjithë procedurave, që të identifikojë dobësitë më herët.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

Një sistem efikas i kontrollit të brendshëm, pjesë e së cilës është edhe auditimi i brendshëm, i ndihmon Menaxhmentit të MTI-së në arritjen e objektivave dhe përdorimin më të mirë të parave publike.

MTI ka formuar Komitetin e Auditimit i cili përbehet prej 3 anëtareve. NJAB ka përgatitur planin strategjik për periudhën 2010 - 2012 dhe planin vjetor për vitin 2010.

Gjatë vitit 2010 ishin finalizuar shtatë raporte të auditimit. Prej tyre katër raporte mbulonin periudhën e vitit 2009, ndërsa tri periudhën e vitit 2010 që ka mbuluar çështjet në vijim:

- për menaxhimin e automjeteve për gjashtë mujorin e parë;
- licencimit të objekteve hoteliere dhe agjencive turistike; dhe
- procedurat e verifikimit të mjeteve matëse të rrjedhës së derivateve.

Konkluzioni

NJAB gjatë vitit 2010 kryesisht ishte fokusuar në auditimin e periudhës së vitit 2009. Për periudhën e vitit 2010 nuk ishte fokusuar në fushat të cilat paraqesin rrezik me të lartë (prokurimin, të hyrat dhe menaxhimin e pasurive).

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së të siguroj:

- Që NJAB gjatë auditimit të përfshijë fushat që paraqesin rrezik me të lartë në mënyrë që ti ndihmojnë dhe ti shtojnë vlerë menaxhimit të organizatës.

VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MTI-së

MTI nuk kishte arritur të krijoj një mjedis funksional të kontrollit të brendshëm i cili do të siguroj një menaxhim efektiv të parasë publike.

Mangësi kishte gjatë mbledhjes dhe raportimit të të hyrave.

Procedurat e prokurimit nuk ishin zhvilluar në pajtim të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore. Gjatë rekrutimit të stafit nuk ishin respektuar kriteret e përcaktuara. Menaxhimi i subvencioneve lë hapësirë për përmirësim.

Pasuritë nuk ishin menaxhuar mjaftueshëm. Kjo krijon hapësirë për humbje dhe keqpërdorimin e tyre.

MTI nuk i ka adresuar të gjitha mangësitë. Masat e marra në lidhje me rekomandimet e auditimit nuk ishin të mjaftueshme.

Duke u bazuar në dobësitë e prezantuara vijmë në konkluzionin të përgjithshëm se nevojiten masa shtesë nga menaxhmenti i MTI-së për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi i përgjithshëm

Ne rekomandojmë Ministrinë e MTI-së që të siguroj:

- Forcimin e kontrolleve të përgjithshme, për të ofruar siguri që aktivitetet operative dhe menaxhimi financiar funksionojnë në pajtim me objektivat e vendosura të MTI-së.

Shtojca I. Komentet e MTI-së dhe përgjigjet e ZAP-it

Menaxhmentit të MTI-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe subjekti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Kapitujt e Raportit	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Komentet e MTI-së	Përgjigjet e ZAP-it
VI. Realizimi i buxhetit					
VI.1 Të Hyrat					
Te gjeturat:			Nuk pajtohem	Të gjitha licencat e lëshuar për subjektet ndërtimore janë lëshuar ne pajtim me UA nr.10/2010, por ndoshta ka paqartësi dhe konfuzitet në nenet e UA, një rekomandim i juaji do te jete i mirëseardhur për plotësimin dhe ndryshimin e UA nr.10/2010. (Shif Dok.4)	Sipas nenit 17 të UA 10/2010 për ushtrimin e kërkesës paraprake për tu pajisur me licencë duhet të dorëzohen dëshmitë për përgatitjen profesionale, dokumentet për pajisjet dhe referencat për punë, Ndërsa kriteret e veçanta klasa e kategori të licencës janë përcaktuar në anekset për klasifikim që janë pjesë përbërëse të këtij UA. Ndërsa ne kemi vërejtur se ishin lëshuar licence që nuk i plotësonin këto kriteret sipas

					UA10/2010. Andaj konstatimi i ZAP-it se ishin lëshuar licenca ndërtimi subjekteve ndërtimore që nuk ishin në pajtim me UA 10/2010 mbetet i pandryshuar.
VI.2 Shpenzimet					
2.1 Blerjet përmes prokurimit					
Te gjeturat:		Pajtohem pjesërisht		2. Në këtë pikë auditori raporton një konstatim jo të mbështetur në fakte, e vërteta qëndron se kërkesë dhe kusht i KEK ka qenë pagesa avans pasi liferimi i trafove dhe pjesës dërmuese të materialeve nga prodhuesit e këtyre pajtimeve marrin kohë deri në 18 muaj d.m.h. pagesa avans është bere për shkak natyrës se liferimit të pajisjeve dhe materialeve. Avans është dhënë vlera prej 950,000.00 € ndërsa prej 498,000.00 € është paguar pas përfundimit të ndërtimit të fazës 20 KV që ka për qëllim furnizimin e	MTI pajtohet pjesërisht me gjeturat se pagesat ishin bërë para fillimit të punimeve,

				<p>përkohshëm deri ne përfundimin e larteperquesit 35 KV.</p> <p>Po ashtu ne këtë fragment të kësaj pike nuk qëndron as konstatimi i auditorit se deri me 23/09/2010 nuk kanë filluar punimet nga ana e KEK(këtu duhet te sjellim ne shënim se auditori thirret ne raportin e OE te mbikëqyrjes se projektit i cili për afër një vite nuk është arritur te sigurohet për shkak mungesës se ofertave te përgjegjshme dhe normalisht ai nuk ka mundur te raportoje për punën qe është zhvilluar me herët), por ne kemi një grup të përbashkët monitorues në takimet e të cilit raportohet për progresin e projektit dhe, nga procesverbalet e takimeve mes KEK dhe MTI te datave 01/03/2010, 07/04/2010 dhe 12/05/2010(te cilat po ju bashkangjesim si prova) shihet se punimet kanë filluar qysh me përmirësimin e motit d.m.th ne mars 2010 dhe komponenta e parë e marrëveshjes (kontratës) ndërtimi i largpërçuesit 20 kV – lidhja kabllore 20 kV ka përfunduar qysh me</p>	<p>Ndërsa sa i përket fillimit të punimeve sipas raportit të organit mbikëqyrës punimet për pjesën TS-35 deri me datën 23.09.2010 ende nuk kishin filluar.</p> <p>Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e ZAP-it mbesin të pandryshuara..</p>
--	--	--	--	---	--

				<p>30/04/2010 dhe po ashtu janë kryer shume pune procedurale e operative për ndërtimin e largpërçuesit 35 kV</p> <p>3. Është e vërtet se dy herë janë bere pagesa te njëjta për automjetet brenda periudhës 2 mujore (Toyota 526-KS-249 dhe Toyota 518-KS-861) por për pozicione te ndryshme. Me datën 15.06.2010 fatura nr.25 është intervenuar ne veturën 526-KS-249 ku janë ndërruar këto pozicionet sponat e shkurta te anës se majte edhe kushinetat e para te anës se majte, ndërsa ne te njëjtën veturë me datën 14.07.2010 me nr te faturës 28, është intervenuar njëjtë si me pare por ne anën e djathtë. Vetura 518-KS-861 me datën 01.06.2010 me faturë nr.23, është intervenuar ne sponat e shkurtra te anës se majte, ndërsa me 04.12.2010 është intervenuar ne pozicione te njëjta por ne anën e djathtë.</p>	<p>Pagesat për ndërrimin e pjesëve të njëjta ishin bërë brenda periudhës dy mujore andaj të gjeturat dhe konkluzionet e ZAP-it mbesin të pandryshuara.</p>
			Nuk pajtohem		
			Nuk pajtohem	<p>Sa i përket subvencioneve dhe transferove janë ne përputhje me Bankën Botërore dhe OEA (Oden</p>	<p>Shpenzimet kishin ndodhur para nënshkrimit te kontratës po ashtu edhe zotimi i mjeteve ishte bërë pas nënshkrimit të</p>

				<p>ekonomike Amerikane) aktiviteti është filluar me marrëveshje që pagesa të realizohet mbasi të përfundoj aktiviteti Transparenca dhe njoftimi për aktivitetin ne fjale është bere edhe ne media dhe ne raportimin e rregullt te BB përkatësisht fondi për punësim te Qëndrueshëm (gjeni te bashkangjitur raportin për BB). Prandaj Zotimi i Mjeteve është bërë menjëherë mbas pranimit të alokimit të mjeteve nga Banka Botërore ne muajin maj. Zotimi me 11.06.2010 Pagesa me 28.06.2010. (Shif.Dok.13).</p>	<p>kontratës . Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e ZAP-it mbesin të pandryshuara.</p>
--	--	--	--	---	--

2.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Te gjeturat:			<p>Nuk pajtohem</p>	<p>Konkursi është institucioni publik që ka vendosur kriteret të barabarta për konkurruesit Andaj të gjithë kandidatëve si brenda ashu edhe jashtë i është dhënë mundësi e barabartë e konkurrimit kjo jep me kuptua se të gjithë konkurruesit kanë qenë te barabartë para ligjit.</p> <p>Shih konkursin publik dhe kualifikimet e kandidatëve paraqitur</p>	<p>Vlerësimi i kandidatëve nuk ishte bërë në mënyrë të drejt, gjatë përzgjedhjes nuk ishin zgjedhur kandidate qe kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me konkurs, andaj nuk është e mjaftueshme që vetëm mundësia për konkurrim të jete e barabartë por duhet që gjatë përzgjedhjes te përzgjidhen kandidatet me te merituar.</p>
--------------	--	--	---------------------	--	--

				për zgjedhjen e kandidatëve për Drejtor të Departamentit Ligjor. (Shih Dok.10)	Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e ZAP-it mbesin të pandryshuara.
3.2 Pasuria kapitale dhe jo kapitale					
Te gjeturat:			Nuk pajtohem	Edhe ne pajtohemi se të gjitha automjetet e MTI-së, duhet të përdorën në pajtim me U.A. 03/2008, por në bazë të nenit 3. paragrafi 3.3 po të njëjtit Udhëzim Administrativ decidivishtë thotë se për shkak të specifikave të posaçme të punës, me vendim të Ministrit të Ministrisë, mund të lejohet përdorimi i automjeteve zyrtare edhe jashtë orarit të punës ku një fenomen i tillë ka ndodhur tek ne në MTI. Shih UA. nr.03/2008 paragrafi 3.3. Shpenzimi i karburanteve mbi normativen për automjetet e MTI-se nuk e dimë se ne bazë se cilave parametra keni konstatuar.	Komenti i MTI-së nuk ka të bëjë me te gjeturat e paraqitura ne raport për përdorimin e veturave jashtë orarit të punës. Sa i përket shpenzimit të automjeteve mbi normativin ne jemi bazuar në raportin e komisionit të formuar nga Sekretari permanent i MTI-së për konstatimin e shpenzimeve të automjeteve të MTI-së. Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e ZAP-it mbesin të pandryshuara.

VII.2 Auditimi i Brendshëm					
Te gjeturat:			Nuk pajtohem	<p>Duke iu referuar Draft Raportit të ZAGJ pika VII. 2 Auditimi i Brendshëm -</p> <p>Menaxhimi i Prokurimit është i auditur për periudhën 2009 si rrjedhojë e asaj se është filluar në fillim të vitit (janar) 2010. Arsyeja është se proceset e prokurimit në fillim të muajit të parë nuk kanë ndodhur dhe me qëllim të prezantimit të një pasqyre rreth funksionimit të kontrollit të brendshëm kemi paraparë që të auditojmë periudhën 2009, dhe përgjatë tërë vitit 2010 ne kemi përcjellë implementimin e rekomandimeve të dhëna .</p>	<p>NJAB e MTI-së për periudhën e vitit 2010 nuk kishte audituar fushat me rrezik të lartë siç është fusha e prokurimit.</p> <p>Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e ZAP-it mbesin të pandryshuara.</p>

Më tutje, Menaxhmenti i MTI-së është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinion i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinion i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionin i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionin i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.